

# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTIPIA E SPORTIT

ADRESA: R.R. "AGIM RAMADAN" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

## RREGULLORE

### E PUNËS SË BORDIT TË

### FEDERATËS SE MUNDJES TË KOSOVËS

Në bazë të nenit 41 paragrafi 12 pika (a) te Statutit të Federatës e Mundjes të Kosovës, Bordi Ekzekutiv i Federatës se Mundjes të Kosovës, në seancën e mbajtur më 06.10 2022, miratoi këtë:


### RREGULLORE TË PUNËS SË BORDIT EKZEKUTIV TË FEDERATËS SE MUNDJES TË KOSOVËS

#### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat e punës dhe vendimmarrjes së Bordit Ekzekutiv të Federatës se Mundjes të Kosovës (në tekstin e mëtejmhë: Bordi).

#### Neni 2

Bordi kryen detyrat e tij në përputhje me dispozitat e Statutit të Federatës se Mundjes të Kosovës dhe të kësaj Rregullore. Bordi do të punojë në seanca, te cilat do të mbahen sipas nevojës.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

## Neni 3

Mandati i anëtarëve të Bordit fillon ditën e zgjedhjes në Kuvend të Federatës se Mundjes të Kosovës të seancës së re. Mandati i të gjithë anëtarëve të Bordit, duke përfshirë edhe ata që zgjidhen më pas, skadon katër vjet nga data e seancës së parë të Bordit.

## Neni 4.

**Seanca e Bordit është publike. Bordi mund të vendosë në diskutimin dhe vendimmarrjen në lidhje me pikat e veçanta të rendit të ditës që seancën ta mbajë pa prezencën e publikut.**

## Neni 5.

Për përgatitjen e seancës merret kryetari i Federatës se Mundjes të Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: kryetari) me ndihmën e Sekretarit të Përgjithshëm.

Kryetari vendos se cilëve, përveç anëtarëve të Bordit, t'ju dërgoj ftesë për të marrë pjesë në mbledhje.

Kryetari është i detyruar të thërrasë një takim të Bordit, nëse kërkohet nga Këshilli Mbikëqyrës, së paku pesë anëtarë të Bordit ose Sekretari i Përgjithshëm i Federatës.

Seanca e përmendor në paragrin 3 të këtij neni do të mbahet jo më vonë se 15 ditë nga data e deponimit të kërkesës.

## Neni 6.

Propozimin e rendit të ditës të seancës së Bordit e përpilon kryetari.


Kryetari i vë në rendin e ditës propozimet e marra nga anëtarët e Bordit, organet e federatës dhe trupat e përhershëm të punës së Bordit.

## Neni 7.

Mbledhjet e Bordit do të thirren me shkrim, kurse mbledhjet emergjente në një mënyrë që siguron një thirrje të sigurt për mbledhje.

Seancën e parë konstitutive të Bordit, Kryetari mund ta thërrasë gojarisht menjëherë pas zgjedhjes së Bordit.

Njoftimi i mbledhjes duhet të përfshijë: vendndodhjen, kohën e mbajtjes dhe propozimin e rendit të ditës të seancës.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: R.R. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

Njoftimi i mbledhjes duhet t'ju dorëzohet anëtarëve të Bordit të paktën pesë ditë para mbajtjes së mbledhjes. Në mënyrë të veçantë kryetari mund të thërrasë një seancë të jashtëzakonshme, brenda një periudhe të shkurtër, por jo më pak se 24 orë nga mbajtja e saj. Kur ekzistojnë arsyë të veçanta, Bordi Ekzekutiv mund të mbajë një seancë me anë të telefonit.

Me ftesën për mbledhje anëtarëve të Bordit u dorëzohet rendi i ditës, materiali për mbledhje si dhe çdo dokumentacion tjetër i nevojshëm.

Me thirrjen për mbledhje, do të dorëzohet i tërë teksti i propozimeve akteve, raportet dhe analizat të cilat do të diskutohen në mbledhje.

Neni 8.

Kryetari mund të refuzojë që në propozim të rendit të ditës të fut ato propozime që ka pranuar nga autoritetet apo personat për të cilat mendon se nuk janë mjaftueshme të përgatitura që të mund të diskutohet në seancë. Në këtë rast, Kryetari do të njoftojë propozuesit për arsyet pse ai hodhi poshtë propozimet.

Neni 9.

Anëtarët e Bordit janë të detyruar që të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit. Anëtarët e Bordit kanë për detyrë të paktën 48 orë përpara fillimit të planifikuar të seancës që të informojnë kryetarin për pamundësinë e mundshme për të marrë pjesë në seancë. Justifikimin e mungesës nga seancat e paraqet kryetari me që rast i sqaron Bordit në fillim të seancës.

Neni 10.


Në fillim të seancës, para përcaktimit të rendit të ditës, Kryetari, në bazë të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm, do të konstatoj se a ka kuorum për mbajtjen e një mbledhje të Bordit.

Në qoftë se konstatohet se nuk ka kuorum, Kryetari do të shtyjë seancën e Bordit për një ditë dhe orë të caktuar.

Në qoftë se gjatë takimit kryetari konstaton se nuk ka kuorum, do ta ndërpret mbledhjen.

Kryetari çdoherë do të përcaktojë nëse ka kuorum, kur këtë e kërkon ndonjëri prej anëtarëve të Bordit.

Kur kryetari konstaton se ka kuorum, kalohet në përcaktimin e rendit të ditës.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: R.R. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

### Neni 11.

Nëse kryetari konstaton se në tri seanca e njëpasnjëshme nuk është siguruar kuorum do të mbledhë Kuvendin për veprime të mëtejshme, në pajtim me Statutin.

### Neni 12.

**Secili anëtar i Bordit mund të kërkojë që në rendin e ditës të futen çështje përpos atyre që jep kryetari dhe propozimet dhe çështje të tjera që i konsiderojnë janë urgjente.**

Anëtari i Bordit është i detyruar që urgjencën e çështjeve apo propozimeve ta shpjegoj. Për rendin e ditës të seancës vendoset pa diskutim (debat).

Në rastin e kërkesave urgjente për pyetje të veçanta ose kur propozohet ndryshimi i rendit të ditës së përcaktuar më parë, kryetari sipas vlerësimit të tij do të vendosë nëse për një kërkesë ose propozim që të hapet diskutimi. Rendi i ditës do të përcaktohet me shumicën e votave të anëtarëve prezent të Bordit.

Një rend dite i përcaktuar mund të ndryshohet gjatë seancës vetëm me përfundim.

### Neni 13.


Kryetari në lidhje me secilën pikë të rendit të ditës para hapjes së diskutimit, jep fjalën raportuesit, ose parashtruesit të propozimit të caktuar.

Në mbledhjen e Bordit çdo anëtar ka të drejtë të flasë.

### Neni 14.

Kryetari merr parasysh shpalosjen e seancës në përputhje me dispozitat e Statutit dhe të Rregullores, si dhe ruajtjen e rendit në seancë.

Në rast të çrregullimit serioz të rendit në seancë ose sjellje që është në kundërshtim me parimet sportive dhe morale, kryetari mund t'i propozojë Bordit që sipas kryerjes së veprës të ndërmerr një prej masave vijuese: vërejtje, qortim, pezullim nga seanca.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTEPIA E SPORTIT

ADRESA: R.R. "AGIM RAMADAN" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

## Neni 15.

Kur diskutohen çështjet nga fushëveprimi i komisioneve të Bordit, të drejtën që të ketë fjalën e kanë dhe pjesëtarët e tyre të cilët nuk janë anëtarë të Bordit.

Anëtarët e Bordit për diskutim lajmërohen me ngritje të dorës dhe kryetari i jep fjalën në mënyrë në të cilën ata janë lajmëruar për të kërkuar fjalën.

Askush nuk mund ta merr fjalën para se të kenë diskutuar të gjithë ata që janë paraqitur, përveç nëse kryetari nuk konsideron të nevojshme për të dhënë një shpjegim të caktuar.

I njëjti person në pikën e njëjtë të rendit të ditës nuk mund të flasë më shumë se dy herë.

**Kryetari mund të propozojë që kohëzgjatja e diskutimit të kufizohet sipas kohës dhe që secili pjesëmarrës në diskutim mbi të njëjtën çështje të diskutoj vetëm një herë, kur konstaton se diskutimi i çështjeve të caktuara mund të marrë kohë, ose kur është paraqitur një numër i madh i folësve. Kufizimin e kohëzgjatja fjalimin mund ta propozojë çdo anëtar i Bordit**

**Kur kohëzgjatja është e kufizuar, në rast të tejkalimit të kohëzgjatjes së rënë dakord të fjalës Kryetari paralajmëron folësin, dhe nëse folësi nuk e përfundon fjalimin kryetari do t'i merr fjalën.**

## Neni 16.


Nëse një anëtar i Bordit kërkon fjalën për të korrigjuar deklaratën që lidhet me të dhe e cila sipas mendimit të tij është e pasaktë, kryetari do t'i japë fjalën sa më shpejt, me të përfunduar personi që shkaktoi nevojën për korrigjime. Anëtari në fjalimin e tij duhet të kufizohet në korrigjim dhe fjalimi i tij nuk mund të zgjasë më shumë se pesë minuta.

## Neni 17.

Folësi mund të flas vetëm për çështje që janë në rendin e ditës.

Nëse folësi largohet nga rendi i ditës, kryetari do ta paralajmërojë atë për të dhe do të kërkon nga ai që të rri në rendin e ditës. Nëse folësi dhe pas thirrjes për të mbajtur rendin e ditës nuk e bënë këtë, kryetari do t'i merr fjalën.

Vendimet merren pas diskutimit, me përjashtim të rasteve kur këto Rregullat



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTIPIA E SPORTIT

ADRESA: R.R. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

përcaktojnë se vendimet duhet të merren pa debat.

## Neni 18.

Kryetari mund të propozojë Bordit që t'a mbylli debatin para se të ketë mbaruar diskutim i folësve të lajmëruar, nëse konsideron se çështja është diskutuar mjaftueshëm. Për këtë propozim votohet pa debat.

Pas diskutimeve të kryera, Kryetari vendos një ose më shumë propozime për të cilat do të vendoset me votim.

## Neni 19.

Para ose pas seancës, Bordi mund të vendosë që një pyetje të veçantë ta heqë nga rendi i ditës.

Bordi mund të marrë vendime të plotfuqishëm nëse në seancë janë prezent shumica e anëtarëve të Bordit.

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve prezent në Bordit, përveç nëse me Statut është përcaktuar shumicë tjeter.

## Neni 20.

Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e propozimit të një akti të përgjithshëm nga kompetencat e Bordit do të paraqitet në formë të amendamentit.

Amendamenti do të dorëzohet jo më vonë se para se të vënë propozimin në votim. Amendamenti, sipas rregullit, paraqitet në formë të shkruar.


## Neni 21.

Në propozim të Statutit, amendamenti do të dorëzohen jo më vonë se dy ditë para datës së caktuar për seancën e Bordit.

Amendamenti do t'i dorëzohet Kryetarit i cili ia paraqet komisionit kompetent të Bordit.

Para votimit të amendamentit përfaqësuesi i komisionit kompetent të Bordit do të sqaroj në lidhje me amendamentin.

Amendamentet votohet sipas renditjes së anëtarëve të aktit të përgjithshëm të cilit i referohen.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: R.R. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

Nëse në të njëjtën dispozitë të aktit të përgjithshëm janë paraqitur më shumë amendamente, për amendamentet votohet me atë renditje që ata janë të dorëzuar.

Amendamentet e pranuara do të bëhen pjesë integrale e propozimit.

## Neni 22.

Me procedurë emergjente mund të miratohet vetëm akti me të cilin rregullohen çështjet dhe marrëdhëniet për të cilat marrëveshje ekziston një nevojë urgjente ose nëse miratimi i akteve të tillë në procedurë të rregullt mund të shkaktojë efekte të dëmshme.

Secili anëtar i Bordit dhe Sekretari i Përgjithshëm mund të paraqesë një propozim të arsyetuar për të vendosur mbi një çështje të caktuar sipas procedurës urgjente.

Macioni për miratimin e aktit nën procedurë urgjente do të vendoset pa debat. Nëse Bordi miraton rekomandimin se akti ka kaluar në procedurë urgjente, akti i propozuar do të futet në rendin e ditës në seancën e njëjtë.

Propozimi i aktit i cili do të sillej në procedurë urgjente duhet t'i dorëzohet anëtarëve të Bordit jo më vonë se fillimi i seancës.

Vendimet merren me votim të hapur, me ngritjen e dorës së anëtarëve të Bordit.


## Neni 23.

Në bazë të propozimeve të paraqitura, Bordi mund të vendosë për të marrë në një çështje të veçantë votim të fshehtë. Votimi i fshehtë kryhet në mënyrë të njëjtë, në fletë votime të vërtetuara.

Me votim të fshehtë, menaxhon një komision i posaçëm, me atë që çdo anëtar i interesuar i Bordit mund të kontrollojë procesin e ndarjes së fletëve të votimit dhe shikimin (qasjen) e tyre pas votimit.

## Neni 24

Për votimin e fshehtë hartohet një listë regjistrimi e veçantë të cilën e vërtetojnë anëtarët e komisionit dhe ajo paraqitet pjesë integrale e procesverbalit të mbledhjes së Bordit.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTETPIJA E SPORTIT

ADRESA: R.R. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

Kryetari fton anëtarët e Bordit sipas listës së zgjedhur të anëtarëve që të pranojnë fletëvotimin, edhe kjo do të evidentohet. Komisioni do të përcaktoj rezultatet e votimit të fshehtë.

## Neni 25

Gjatë procedurës së votimit anëtarët e Bordit mund të deklarohen: "PËR", "KUNDËR" ose "ABSTENIM".

Kur vendoset me vota të fshehta, një fletëvotimit në të cilin është rrumbullakuar vetëm një prej këtyre tre përgjigjeve që u përmendën, atëherë është e vlefshme. Gjatë votimit, të hapur apo të fshehtë, askush nuk mund të merr fjalën para njoftimit të rezultateve të votimit.

## Neni 26


Te zgjedhjet me votim të fshehtë, çdo anëtar i Bordit merr një fletëvotim ku janë shkruar emrat e kandidatëve sipas rendi të nominimit, kurse para çdo emri është shënuar numri rendor.

Anëtari voton në atë mënyrë që rrumbullakon numrin rendor para emrave të kandidatëve për të cilin voton.

Nëse numri i fletëve të votimit që janë mbledhur pas votimit është më i madh sesa numri që është i ndarë nga anëtarët e Bordit, votimi do të anulohet dhe përsëritet.

## Neni 27

Pas përfundimit të diskutimit dhe vendimmarrjes në lidhje me të gjitha çështjet që janë në rendin e ditës, Kryetari përfundon seancën. Kur për shkak të shtrirje (vëllimit) të rendit të ditës, ose për arsyet e tjera nuk është e mundur për të përfunduar diskutimin mbi të gjitha çështjet e rendit të ditës në ditën e caktuar, Bordi mund të vendosë të ndërpresë seancën dhe të planifikojë të vazhdoj seancën për një ditë të caktuar, për të cilën me shkrim informohen vetëm anëtarët e Bordit që mungojnë në seancë.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHITËPIA E SPORTIT

ADRESA: R.R. "AGIM RAMADAN" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

## Neni 28

Gjatë seancës së Bordit mbahet evidencë (procesverbal), të cilin duhet ta nënshkruajnë kryetari dhe procesmbajtësi.

Teksti integral i vendimeve i jepet i bashkangjitur procesverbalit.

Bordi miraton procesverbalin në seancën e parë të ardhshme të Bordit.

Teksti origjinal i procesverbalit do të bëhet në dy kopje.

Gjatë seancës mund të kryhen shënimë stenografike të procesverbalit, ose të regjistrohet (me aparatura tjera) për të cilën vendos kryetari,

## Neni 29

Bordi mund t'i propozojë Kuvendit tërheqjen e anëtarëve individualë të bordit, për shkak të mosrespektimit të Statutit dhe akteve tjera të përgjithshme të Federatës, apo për shkak të mungesës në mbledhjet e Bordit.

## Neni 30.

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi në ditën e miratimit të saj dhe menjëherë do zbatohet.

Prishtinë, më  
06.10.2022

Kryetari i FMK-se:  
Naim Muja

